



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 437/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.10.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-65655-07-15-2020, me objekt “*Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës*”, me fond limit 1.666.660 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: “Alstezo” sh.a.
Lagja “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Aulona”, Fier

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi “Skënderbej”, Nr. 3, Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Servis Auto 2000” sh.p.k.
Rruga “Enriko Telini”, Nd. 15, H. 1, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-65655-07-15-2020, me objekt “*Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës*”, me fond limit 1.666.660 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 27.07.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 04.08.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------------|------------------------------|
| 1. “Alstezo” sh.a. | 1.231.800 lekë, skualifikuar |
| 2. “Servis Auto 2000” sh.p.k. | 1.254.530 lekë, kualifikuar |
| 3. “Auto Manoku Servis” sh.p.k. | 1.323.900 lekë, kualifikuar |
| 4. “Kadiu” sh.a. | 1.579.700 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 04.08.2020 operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 Kapaciteti teknik, pika 5, gërma b, pasi për servisinqë disponon jashtë qarkut, ku ndodhet autoriteti kontraktor, nuk arriti të paraqesë deklaratë se merr përsipër, se do të kryerjë me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas.

II.5. Në datën 05.08.2020 operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

Jemi njohur në Sistemin Elektronik te Prokurimit Publik me klasifikimin e ofertave me dt. 04.08.2020, në të cilin ne si operator ekonomik jemi skualifikuar me arsyetimin, si vijon:

Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 Kapaciteti teknik, pika 5, gërma b, pasi për servisinqë disponon jashtë qarkut, ku ndodhet autoriteti kontraktor, nuk arriti të paraqesë deklaratë se merr përsipër, se do të kryerjë me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas.

E kundërshtojme kete klasifikim te bere nga AK, lidhur me skualifikimin e ofertes tone te paraqitur ne kete procedure prokurimi, me arsyetimin si me poshte: Ne DST, ne kushtet e vecanta te kualifikimit, Shtojca 7, kerkohet si vijon:

2.3. Per kapacitetin teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, me siperfaqe minimale 100 m², ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë, e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose*
- kontrata e shitblerjes; ose*
- kontrata e dhurimit; ose*
- çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

➤ Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.*
- Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
- Kontratë qiraje.*

b) Nëse servisi, që disponon operatori ekonomik, ndodhet jashtë qarkut, ku ndodhet autoriteti kontraktor, operatori ekonomik duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do

të kryerjës, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10. Ne permbushje të këtij kriteri ne kemi paraqitur dokumentin perkates per servisin Fier dhe Servisin Kashar – Tirane. Ne keto kushte bashke me oferten tone ne përmbushje të kriterit të mesiperm 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 5, germa b, kemi dorezuar pikerisht Deklaraten lidhur me transportin e mjeteve per riparim, duke marre persiper te gjitha detyrimet qe lindin per keto transporte respektivisht te mjeteve, ne permbushje te kriterëve per procedure me objekt: “Riparim dhe mirembajtje automjetesh per Drejtorine Vendore te Policise Durres”, per te gjitha shërbimet e kerkuara ne shtojcen 10, nga AK ne Servisin tone perkates, (bashkengjitur Deklarata e paraqitur ne SPE, bashke me oferten tone per kete procedure prokurimi) si vijon:

Deklarate

Deklarojmë se Shoqëria Alstezo sh.a., ne permbushje te kriterëve per: “Riparim dhe mirembajtje automjetesh per Drejtorinë Vendore te Policise Durres, me fond limit 1.666.660 leke, pa tvsh merr persiper kryerjen e transportit të mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri ne servis dhe anasjelltas, per te gjitha shërbimet e kerkuara ne shtojcen 10.

Sa me siper, pretendimi i AK, se ne si OE nuk kemi paraqitur deklaraten nepermjet te ciles marrim persiper transportin e mjeteve, ne permbushje te kriterëve te vendosura ne kete procedure prokurimi, nga vendndodhja e autoriteti kontraktor deri ne servis dhe anasjelltas, nuk qendron. Perfundimisht, kerkojme riklasifikim te ofertes tonë ne kete procedure prokurimi, pasi i plotesojme te gjitha kerkesat e paraqitura nga AK ne DST per kete procedure prokurimi.

II.6. Autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1548/2 prot., datë 11.08.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë me argumentimin si më poshtë:

[...]

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi “Alstezo” sh.a. në përmbushje të kriterit të përcaktuar në gjurmën “b” pika 5 seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” shtojca nr.7 ka dorëzuar në datë 27.07.2020 ora 08:36 dokumentacionin me emërtim “DVP_Durrës_Deklaratat_A”. Pjesë e këtij dokumentacioni është dhe “Deklarata”, ku shoqëria “Alstezo” sh.a. ka deklaruar së në përmbushje të kriterëve për “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore te Policise” me fond limit 1.666.660 lekë pa Tvsh merr përsipër kryerjen e transportit të mjeteve nga vendndodhja e autoriteti kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10. Sa më sipër ofertuesi “Alstezo” sh.a. në deklaratën e dorëzuar lidhur me transportin e mjeteve për shërbimet e kërkuara në dokumentet e tenderit, nuk ka deklaruar se kete shërbim do ta kryeje me shpenzimet e veta ashtu sic është kërkuar nga organi qendror blerës. Bazuar në LPP, I ndryshuar, neni 53 pika 3 [...], organi qendror blerës ka bërë skualifikimin e ofertuesit “Alstezo” sh.a. Për arsytet e mësipërme pretendimi i ofertuesit “Alstezo” sh.a. nuk pranohet.

II.7. Në datën 19.08.2020 operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjta pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1654/1 prot., datë 31.08.2020, protokolluar me tonën në datën 03.09.2020, me objekt “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Riparim

dhe mirëmbajtje automjeteve për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike *“Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 Kapaciteti teknik, pika 5, gërma b, pasi për servisën që disponon jashtë qarkut, ku ndodhet autoriteti kontraktor, nuk arriti të paraqesë deklaratë se merr përsipër, se do të kryerjë me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas”,* nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, pika 2.3 *“Për Kapaciteti teknik”,* pika 5, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

5. *Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, me sipërfaqe minimale 100 m², ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

a) *Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:*

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- *Çertifikata e pronësisë, e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose*
- *kontrata e shitblerjes; ose*
- *kontrata e dhurimit; ose*
- *çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- *Kontratë huaje.*

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- *Kontratë qiraje.*

b) *Nëse servisi, që disponon operatori ekonomik, ndodhet jashtë qarkut, ku ndodhet autoriteti kontraktor, operatori ekonomik duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do të kryerjë, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (S.P.E) nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Certifikatë për Vërtetimin e Pronësisë, lëshuar në emër të subjektit “Alstezo” sh.a., për llojin e pasurisë Ndërtesë, me sipërfaqe totale 634.80 m², me adresë “Fier, Rruga L. Kryengritje Fierit”. Shoqëruar me Kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe Hartën treguese të regjistrimit.
2. Kontratë huapërdorje ambienti me datë 29.01.2020, lidhur ndërmjet huadhënësit z. A.Z dhe huapërdorësit shoqërisë “Alstezo” sh.p.k. Sipas kësaj kontrate Huadhënësi ka në pronësi këto pasuri të paluajtshme:
 - Tokë arë me sipërfaqe 1424 m², me adresë pasurie Kashar Tiranë, me nr. pasurie 1171/44 [...] shoqëruar më Certifikatën e Pronësisë.
 - Tokë arë me sipërfaqe 2057 m², me adresë pasurie Kashar Tiranë, me nr. pasurie 1171/42 [...] shoqëruar më Certifikatën e Pronësisë.
 - Tokë arë me sipërfaqe 2400 m², me adresë pasurie Kashar Tiranë, me nr. pasurie 1171/45 [...] shoqëruar më Certifikatën e Pronësisë.
 - Tokë arë me sipërfaqe 1400 m², me adresë pasurie Kashar Tiranë, me nr. pasurie 1171/46 [...] shoqëruar më Certifikatën e Pronësisë.

Mbi këto toka arë janë ndërtuar këto objekte përkatësisht:

- Servis Kat 0:0, me sipërfaqe 1814 m²;
 - Servis Kat -1:0, me sipërfaqe 907 m²;
 - Magazinë Kat 0:0, me sipërfaqe 777 m²;
 - Zyra Kat 0:0, me sipërfaqe 777 m²
 - Zyra Kat +1:0, me sipërfaqe 585 m².
3. Dokumentin « Deklaratë » ku citon: “Deklarojmë se shoqëria “Alstezo” sh.a. në përmbushje të kriterëve për “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për Drejtorinë Vendore të Policisë” me fond limit 1.666.660 lekë pa Tvsh merr përsipër kryerjen e transportit të mjeteve, transportin e mjeteve, nga vendodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10.”
 4. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të nënshkruar nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
 5. Shtojca 8 “Specifikimet teknike” të nënshkruar nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
 6. Shtojca 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të nënshkruara nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
 7. Shtojca 11 “Termet e referencës” të nënshkruara nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.5. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në pikën 2.3.5/b të Kapacitetit teknik autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që “nëse servisi, që disponon operatori ekonomik, ndodhet jashtë qarkut, ku ndodhet autoriteti kontraktor, operatori ekonomik duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do të kryerjë, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10”.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur dokumentacionin me anë të të cilit vërteton se ambientet e serviseve që ky i fundit disponon janë në Qarkun Tiranë dhe në Qarkun Fier, ndërkohë që institucioni për të cilin po zhvillohet kjo procedurë prokurimi ndodhet në Qarkun Durrës. Për këtë arsye, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur deklaratën sipas pikës 5/b të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit ku citon: “Deklarojmë se shoqëria “Alstezo” sh.a. në përmbushje të kritereve për “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë” me fond limit 1.666.660 lekë pa Tvsh merr përsipër kryerjen e transportit të mjeteve, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10.”

Sa më sipër, nga shqyrtimi i kësaj deklarate, KPP gjykon se, operatori ekonomik ankimues në mënyrë të shprehur ka deklaruar se merr përsipër kryerjen e transportit të mjeteve nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, sipas të gjitha shërbimeve të parashikuara në shërbimin dhe grafikun e ekzekutimit të dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi. Pra sa më sipër, operatori ekonomik ankimues për sa kohë kryen aktivitetin e tij jashtë qarkut të institucionit për të cilin po kryhet kjo procedurë prokurimi, ka plotësuar deklaratën sipas kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 5/b të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit. Akoma më tej, operatori ekonomik ankimues ka nënshkruar mbi shtojcën “Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike”, Shtojcën 8 “Specifikimet teknike”, Shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” dhe Shtojcën 11 “Termet e referencës”, duke marrë kështu përsipër përmbushjen e të gjitha shërbimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-65655-07-15-2020, me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës”, me fond limit 1.666.660 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik nga procedura e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Nr. 980 Protokolli

Datë 19.08.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik znj. Enkeleda Bega (Nënkryetar) dhe znj. Vilma Zhupaj (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtarë të KPP shprehim mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, përse i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., konkretisht nuk jemi dakord me arsyetimin në pikën III.1 e në vijim, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-65655-07-15-2020, me objekt “*Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës*”, me fond limit 1.666.660 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetojmë

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sh.a. se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “*Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 Kapaciteti teknik, pika 5, gërma b, pasi për servis që disponon jashtë qarkut, ku ndodhet autoriteti kontraktor, nuk arriti të paraqesë deklaratë se merr përsipër, se do të kryerjë me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas*”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, pika 2.3 “*Për Kapaciteti teknik*”, pika 5, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

6. *Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, me sipërfaqe minimale 100 m², ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
 - c) *Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:*

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë:
 - Çertifikata e pronësisë, e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
 - kontrata e shitblerjes; ose
 - kontrata e dhurimit; ose
 - çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:
 - Kontratë huaje.
 - Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:
 - Kontratë qiraje.
- d) Nëse servisi, që disponon operatori ekonomik, ndodhet jashtë qarkut, ku ndodhet autoriteti kontraktor, operatori ekonomik duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do të kryerjë, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (S.P.E) nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Certifikatë për Vërtetimin e Pronësisë, lëshuar në emër të subjektit “Alstezo” sh.a., për llojin e pasurisë Ndërtesë, me sipërfaqe totale 634.80 m², me adresë “Fier, Rruga L. Kryengritje Fierit”.

Shoqëruar me Kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe Hartën treguese të regjistrimit.

2. Kontratë huapërdorje ambienti me datë 29.01.2020, lidhur ndërmjet huadhënësit z. A.Z dhe huapërdorësit shoqërisë “Alstezo” sh.p.k. Sipas kësaj kontrate Huadhënësi ka në pronësi këto pasuri të paluajtshme:

- Tokë arë me sipërfaqe 1424 m², me adresë pasurie Kashar Tiranë, me nr. pasurie 1171/44 [...] shoqëruar me Certifikatën e Pronësisë.
- Tokë arë me sipërfaqe 2057 m², me adresë pasurie Kashar Tiranë, me nr. pasurie 1171/42 [...] shoqëruar me Certifikatën e Pronësisë.
- Tokë arë me sipërfaqe 2400 m², me adresë pasurie Kashar Tiranë, me nr. pasurie 1171/45 [...] shoqëruar me Certifikatën e Pronësisë.
- Tokë arë me sipërfaqe 1400 m², me adresë pasurie Kashar Tiranë, me nr. pasurie 1171/46 [...] shoqëruar me Certifikatën e Pronësisë.

Mbi këto toka arë janë ndërtuar këto objekte përkatësisht:

- Servis Kat 0:0, me sipërfaqe 1814 m²;
- Servis Kat -1:0, me sipërfaqe 907 m²;
- Magazinë Kat 0:0, me sipërfaqe 777 m²;
- Zyra Kat 0:0, me sipërfaqe 777 m²
- Zyra Kat +1:0, me sipërfaqe 585 m².

3. Dokumentin « Deklaratën » ku citon: “Deklarojmë se shoqëria “Alstezo” sh.a. në përmbushje të kriterëve për “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë” me fond limit 1.666.660 lekë pa Tvsh merr përsipër kryerjen e transportit të mjeteve, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10.”

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.5. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në pikën 2.3.5/b të Kapacitetit teknik autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që “nëse servisi, që disponon operatori ekonomik, ndodhet jashtë qarkut, ku ndodhet autoriteti kontraktor, operatori ekonomik duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do të kryerjë, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10”.

III.1.6. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur dokumentacionin me anë të të cilit vërteton se ambjentet e serviseve që ky i fundit disponon janë në Qarkun Tiranë dhe në Qarkun Fier, ndërkohë që institucioni për të cilin po zhvillohet kjo procedurë prokurimi ndodhet në Qarkun Durrës. Për këtë arsye, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur deklaratën sipas pikës 5/b të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit ku citon: *“Deklarojmë se shoqëria “Alstezo” sh.a. në përmbushje të kriterëve për “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë” me fond limit 1.666.660 lekë pa Tvsh merr përsipër kryerjen e transportit të mjeteve, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 10.”*

Sa më sipër, KPP, nga shqyrtimi i kësaj deklarate, konstaton se, kjo e fundit nuk është plotësuar sipas të gjithave të dhënave dhe elementëve konkret që autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht në plotësimin e këtij vetëdeklarimi nga ana e operatorëve ekonomikë. Konkretisht, operatori ekonomik ankimues nuk shpreh në vetëdeklarimin e mësipërm, se shërbimin e transportit të automjeteve nga institucioni në servis dhe anasjelltas do ta kryejë me shpenzimet e tij, element ky i kërkuar nga autoriteti kontraktor që të citohet shprehimisht nga operatorët ekonomikë në këtë vetëdeklarim.

III.1.7. Komisioni rithekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën

e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Referuar dokumentacionit sa më sipër, të paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a, në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor për deklaratën sipas pikës 5/b të “Kapacitetit teknik”, konstatohet se, operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. për sa kohë kryen aktivitetin e tij jashtë qarkut të institucionit për të cilin po kryhet kjo procedurë prokurimi, nuk ka plotësuar deklaratën sipas kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik “Alstezo” sh.a. nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7, pika 2.3. “Për kapacitetin teknik”, pika 5/b, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.9. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, të ndryshuar. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin

procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Si rrjedhojë e arsytimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, gjykojmë:

Të mos pranohet ankesa e operatorit ekonomik “Alstezo” sh.a. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-65655-07-15-2020, me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës”, me fond limit 1.666.660 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj